



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 dhe 16 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 2 par. 7 të Ligjit për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor nr. 02/L-70, nenit 4 të Ligjit për Rregullat e Trafikut rrugor, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 32 e datës 5 shtator 2016 dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 30. 04.2018, pas shqyrtimit të propozim vendimit të Kryetarit miratoi këtë:

V E N D I M
PËR RREGULLIMIN E KOMUNIKACIONIT RRUGOR NË DISA RRUGË TË
QYTETIT TË LIPJANIT

Neni 1

Me këtë Vendim rregullohet: mënyra e parkimit të automjeteve, kufizimi i shpejtësisë së lëvizjes në rrugë dhe komunikacionit me një drejtim në disa rrugë të qytetit të Lipjanit.

Neni 2

- 1.Rruga "Gjergj Fishta" me fillim nga kryqëzimi me rrugën "Skënderbeu" dhe mbarim me rrugën "Lidhja e Prizrenit" (Semaforët) përcaktohet rrugë një kahore për lëvizje të automjeteve dhe ndalim parkingu në të dy shiritat e rrugës.
2. Rruga "Isa Olluri" me fillim nga kryqëzimi me rrugën "Tahir Sinani" dhe përfundim me rrugën "Haradin Bajrami" përcaktohet rrugë një kahore për lëvizje të automjeteve, shiriti rrugor i krahut të djathtë të jetë parking ku 20 vende janë të rezervuara për auto taksi ndërsa shiriti i krahut të majtë për lëvizje të automjeteve.
3. Rruga "Xhavit Kozhani" me fillim në kryqëzim me rrugën "Komandant Kumanova" dhe mbarim me rrugën "Skënderbeu" përcaktohet rrugë një kahore me lëvizje të automjeteve, shiriti rrugor i krahut të djathtë të jetë parking ndërsa shiriti rrugor i krahut të majtë për lëvizje të automjeteve.
- 4 Rruga "Hamzë Jashari" me fillim në kryqëzim me rrugën "Gjergj Fishta" dhe mbarim me Sheshin "Adem Jashari" përcaktohet rrugë dy kahore për lëvizje të automjeteve me ndalim parkingu.
5. Rruga dytësore pa krye që lidhet me rrugën "Hamzë Jashari" mbrapa objektit banesor ku vazhdon deri në parkingun mbrapa postës përcaktohet rrugë dy kahore për lëvizje të automjeteve me ndalin ndalje dhe parkingu.

6. Rruga "1 Qershori" me fillim nga rruga "Hamzë Jashari" dhe mbarim në parkingun mbrapa çerdhes së fëmijëve përcaktohet rrugë një kahore për lëvizje të automjeteve me ndalim ndalje dhe parkingu.
7. Rruga "Shën Flori" me fillim nga rrethrotullimi te shtëpia e kulturës dhe mbarim në kryqëzim me rrugën "Skënderbeu" përcaktohet rrugë dy kahore për lëvizje të automjeteve me parkim në krahun e djathtë të rrugës nga rrethrotullimi prej shtëpisë së kulturës.
8. Rruga "Skënderbeu" me fillim nga kryqëzimi me rrugën "Shqipëria" dhe mbarim me rrugën "Shën Flori" (përballë Kishës Ortodokse) përcaktohet rrugë dy kahore për lëvizje të automjeteve me parkim në krahun e majtë jashtë shiritave qarkullues të rrugës dhe ndalim qarkullimi për automjetet e rënda mbi 3.5t.
9. Rrugët me katër korsi "Lidhja e Prizrenit", "Komandant Kumanova" dhe "Avdi Kelmendi" përcaktohen rrugë me ndalim parkimi në të katër shiritat e rrugës.
10. Rruga me katër korsi "Haradin Bajrami" me fillim prej kryqëzimit me rrugën "Zylfie Gashi" deri te rrethrotullimi i rrugës Magjistrale "Ibrahim Rugova" përcaktohet rrugë me kufizim të shpejtësisë prej 50 km/h.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

15Nr. 345 - 28060
Lipjan, më 02. 05. 2018

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

